



**UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”  
UNIVERSITY OF MITROVICA**

**FAKULTETI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE  
FACULTY OF FOOD TECHNOLOGY**

Rr. “Ukshin Kovaçica”, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

<http://www.umib.net>; Tel: +381-28530446

**RAPORTI VJETOR I PUNËS**

**JANAR – DHJETOR 2019**

**Mitrovicë**

**Mars 2020**

## **1. HYRJE**

Bazuar në nenin 65 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit Publik të Mitrovicës “Isa Boletini”, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore është njësi akademike e Universitetit, përgjegjës për ofrimin e programeve të arsimit të lartë dhe kërkimeve shkencore në lëmin e Inxhinierisë Kimike, Mbrojtjes së Mjedisit, Inxhinierisë dhe Teknologjisë Ushqimore.

Gjatë vitit 2019 Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore është përkushtuar në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive me qëllim të përmbushjes së objektivave të përcaktuara.

Ndër objektivat kryesore kanë qenë:

- Vazhdimi i ngritjes të cilësisë së mësimin,
- Pajisja e laboratoreve me pajisje laboratorike,
- Zgjerimi i bashkëpunimit me kompanitë prodhuese për punë praktike të studentëve.
- Angazhimi i personelit në ngritjen profesionale-shkencore.
- Përgatitja e programeve të studimit për riakreditim

Me përkushtimin e personelit akademik dhe stafit mbështetës (administratës) gjatë vitit 2019, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore ka arritur ti përmbush me sukses objektivat e përcaktuara lidhur me procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Në këtë raport në mënyrë të përmbledhur janë përshkruar aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2019.

## **2. PROCESI I AKREDITIMIT**

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore në vitin 2019 ka parashtruar kërkesën në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për riakreditimin e programeve të studimeve. Programet e riakredituara janë dhënë në tabelën vijuese.

Me datën 15.05.2019 është zhvilluar vizita e ekspertëve në FTU. Pas rekomandimit të ekspertëve të akreditimit, Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e mbajtur me datën 15.07.2019 ka marrë vendim për riakreditimin e katër programeve të studimit për tri vite (3) vite. Programet e studimeve janë të akredituara deri më 30.09.2022.

	PROGRAMI	NIVELI I STUDIMIT
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE	Teknologji me specializimet, a) Inxhinieri e Mjedisore b) Inxhinieri Kimike	Bachelor
	Teknologji me specializimet, a) Inxhinieri e Mbrojtjes Mjedisore b) Inxhinieri Kimike	Master
	Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore	Bachelor
	Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore	Master

### 3. MBARËVAJTJA E MËSIMIT

Procesi i mbarëvajtjes së mësimin në Fakultet është zhvilluar normalisht sipas planifikimit. Në FTU, provimet janë organizuar sipas dinamikës së përcaktuar, bazuar në dispozitat e Rregullores për Studimet Themelore-Bachelor dhe Rregullores për Studimet Master, si dhe në vendimet e Senatit të UMIB-it.

### 4. PROCESI I REGJISTRIMIT TË STUDENTËVE

Procesi i regjistrimit të studentëve në vitin akademik 2019/2020 nuk është zhvilluar. Arësyeja? Mos akreditimi i Universitetit të Mitrovicës ‘Isa Boletini’ nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.

### 5. ZGJEDHJET NË FAKULTETIN E TEKNOLOGJISË USHQIMORE

Gjatë vitit 2019 në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore janë mbajtur zgjedhjet e rregullta sipas rregulloreve në fuqi të UMIB. Zgjedhjet janë bërë për Këshill të Studentëve, Këshill të Fakultetit, Dekan dhe Senator. Zgjedhjet kanë qenë të rregullta, të sukseshme dhe pa asnjë vërejtje. Nga këto zgjedhje është formuar Këshilli i Fakultetit, është zgjedhur një Senator për Senatin e UMIB-it dhe Dekani me mandat 4 vjeçar.

Janë formuar komisionet përkatëse siç kërkohet me Status për funksionimin e institucionit. Është zgjedhur prodekani, shefi dhe koordinatori për zhvillim akademik.

## 6. REKRUTIMI/ANGAZHIMI I PERSONELIT AKADEMIK

Procesi i rekrutimit/angazhimit të personelit akademik është zhvilluar bazuar në analizën e nevojave për mësimdhënës brenda njësisë akademike. Rekrutimi/angazhimi është bërë përmes konkursit publik sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin e aplikueshëm në UMIB.

Gjatë vitit 2019, është zhvilluar një (1) procedure e rekrutimit.

- Një procedurë për rizgjedhje/avancim të personelit akademik dhe plotësim të vendeve të lira

Numri i personelit të rekrutuar gjatë vitit 2019 është si në vijim:

Rekrutimi	Prof. Dr.	Prof. Asoc.	Prof. Ass.	Ass.	Ligjërues
Rizgjedhje/avancim	1	0	0	0	0
Zgjedhje/pranim nga jashtë	0	0	1	0	0

## 7. KËSHILLI I FAKULTETIT

Këshilli i Fakultetit, ka zhvilluar punën bazuar në Statutin e UMIB-it dhe Rregulloren mbi zgjedhjet në Universitetin e Mitrovicës dhe punën e Këshillit të Fakultetit.

Gjatë vitit 2019, Këshilli i Fakultetit, ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta, ku janë diskutuar dhe marrë vendime të përkatëse në kuadër të fushëveprimtarisë së njësisë akademike.

## 8. BASHKËPUNIMET

Në kadër të programit Erasmus+ edhe gjatë vitit 2019 ka vazhduar bashkëpunimi me Universitetin për Shkenca të Aplikuara Van Hall Larenstein në Holandë. Dy profesorë nga Holanda për pesë ditë ka mbajtur ligjërata për studentët e FTU-s. Katër studentë të FTU-s për pesë muaj kanë vijuar mësimin në Universitetin Van Hall Larenstein të Holandës. Po ashtu katër studentë nga Holanda të ndarë në dy grupe nga dy kanë qëndruar për 1.5 muaj në FTU. Grupi i fundit punën e realizuar në laboratorët e FTU-s e kanë prezantuar para prof. nga Holanda dhe atyre të FTU-s. Dy mësimdhënës të FTU-s për një javë kanë qëndruar në Universitetin Van Hall Larenstein. Ata kanë mbajtur ligjërata për studentët vendor.

Gjatë vitit 2019, është nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi për bashkëpunim të ndërsjellë në mes të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe Shoqatës së Verëtarëve të Kosovës “Enologjia” në Rahovec.

Po ashtu është nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi për themelimin e Qendrës së Ekspertizës në mes të Shoqata e Industrisë së Qumështoreve të Kosovës, UMIB-it përkatësisht Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, Universitetit për Shkenca të Aplikuara Van Hall Larensten të Holandës dhe organizatës holandeze YUNIKO.

### **9. PJESEMARRJA NË KONFERENCA DHE TË TJERA**

Profesorë të FTU-s kanë marrë pjesë dhe janë prezantuar me punimet e tyre në konferencën ndërkombëtare të organizuar nga Fakulteti i Gjeoshkencave.

Një profesor nga FTU ka marrë pjesë në një konferencë të organizuar nga Universiteti i Kamerinos në Itali.

Profesorë dhe asistentë të FTU-s kanë vazhduar punën shkencore hulumtuese. Rezultatet e kësaj pune i kanë publikuar në revista ndërkombëtare.

### **10. INVENTARIZIMI DHE PAJISJA E LABORATOREVE ME PAJISJE LABORATORIKE**

Gjatë vitit 2019 është bërë inventarizimi i tetë laboratoreve me tavolina pune dhe pjesë përcellëse si sirtarë etj. Janë blerë Me pajisje laboratorike nga më të ndryshmet, varësisht prej fushës që do përdore. Për analiza të produkteve ushqimore, për analiza instrumentale, për përcaktimin e ndotësve të ajrit, ujit dhe dheut etj. Mjetet e investuara me këtë rast kanë qenë 285,470.00 €.

Dekani

Prof. Asoc. Dr. Milaim Sadiku

---